



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUFSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

Në mbështetje të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.3, 1.4, 1.24, nenin 30 dhe 31 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenin 14 dhe nenin 15 të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, neni 15 dhe neni 16 të Ligjit Nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, nenit 9, 12 dhe 14 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në mbledhje e mbajtur më datë 27 dhjetor 2022,

Miraton:

**RREGULLORE Nr. 12/2022
PËR PROCEDURËN E ZGJEDHJES, EMËRIMIT, PEZULLIMIT DHE
SHKARKIMIT TË KRYETARËVE TË GJYKATAVE DHE
GJYQTARËVE MBIKËQYRËS**

**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Me këtë rregullore përcaktohen procedurat për procesin e zgjedhjes, emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës.
2. Kjo rregullore zbatohet ndaj të gjithë kandidatëve për kryetar të gjykatave dhe gjyqtarë mbikëqyrës, komisioneve të themeluara me këtë rregullore si dhe ndaj të gjithë zyrtarëve të tjerë të Këshillit dhe gjykatave përkatëse të cilët janë të përfshirë në këtë proces.

**Neni 2
Përkufizimet**

1. Përkufizimet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

- 1.1. **Ligji** - Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.2. **Këshilli** - Këshillin Gjyqësor të Kosovës, siç është përcaktuar në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;

- 1.3. **Kryesuesi** - Kryesuesin e Këshillit, ashtu siç parashihet në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.4. **Sekretariati** - nënkupton Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, siç është përcaktuar në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.5. **Njësia** - Njësinë për Inspektim Gjyqësor, siç parashihet në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.6. **Kryetari i Gjykatës** – gjyqtar përgjegjës për menaxhimin e gjykatës dhe sigurimin e funksionimit efikas të saj, siç përcaktohet me Ligjin për Gjykatat dhe me Ligjin për Gjykatën Komerciale;
- 1.7. **Gjyqtarë Mbikëqyrës** – Gjyqtari i cili menaxhon në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme i cili për veprimet e tij lidhur me Dhomën e Posaçme i përgjigjet kryetarit të Gjykatës Supreme, siç përcaktohet me Ligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe gjyqtari në krye të degës së gjykatës themelore, i cili për veprimet e asaj dege i përgjigjet kryetarit të gjykatës themelore, siç përcaktohet në Ligjin për Gjykatat;
- 1.8. **Komision Vlerësues** – Komision ad hoc i themeluar nga Këshilli, përgjegjës për intervistimin, vlerësimin dhe rekomandimin e kandidatëve më të suksesshëm për kryetarë të gjykatës dhe gjyqtarë mbikëqyrës tek Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
- 1.9. **Anëtar i Komisionit** – anëtarin e emëruar nga Këshilli, i cili kryen detyrat dhe përgjegjësi në pajtim me këtë rregullore;
- 1.10. **Anëtar rezervë** - anëtarin e emëruar nga Këshilli i cili zëvendëson anëtarët e komisionit në rast të konfliktit të interesit sipas përcaktimit të bërë me ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik apo rastet tjera të pengesave eventuale gjatë ushtrimit të detyrës si anëtar;
- 1.11. **Subjekt bartës të procesit** - Komisioni Vlerësues, zyrtarët e Njesisë, zyrtarët e Sekretariatit dhe, zyrtarët të gjykatave përkatëse.

2. Shprehjet e përdorura në njëjës e kanë të njëjtin kuptim edhe në shumës. Fjalët e përdorura në një gjini përfshijnë edhe gjininë tjetër.

Neni 3 Parimet themelore

1. Zgjedhja dhe emërimi i kryetarit të gjykatës dhe gjyqtarit mbikëqyrës duhet të pasqyrojë natyrën shumë etnike dhe parimet e barazisë gjinore, siç janë të garantuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës.

2. Zgjedhja dhe emërimi i kryetarit të gjykatës dhe gjyqtarit mbikëqyrës bëhet përmes një procesi konkurrues, transparent, meritore dhe të hapur për monitorim nga organizatat e interesuara, siç përcaktohet me ligj dhe aktet e tjera të miratuara nga Këshilli, duke përjashtuar çfarëdo lloj diskriminimi.

3. Zgjedhja dhe emërimi i kryetarit të gjykatës dhe gjyqtarit mbikëqyrës bëhet duke zbatuar kritere objektive me qëllim të sigurimit të pavarësisë, paanshmërisë, profesionalizmit, transparencës dhe menaxhimit efikas e efektiv të gjykatës dhe degëve.

KAPITULLI II

EMËRIMI I KRYETARËVE DHE GJYQTARËVE MBIKËQYRËS

Neni 4

Shpallja e pozitës së lirë

1. Këshilli me vendim shpall pozitën e lirë jo më vonë se dyzetepesë (45) ditë, para skadimit të mandatit të kryetarit apo gjyqtarit mbikëqyrës.

2. Në rast kur pozita e kryetarit dhe gjyqtarit mbikëqyrës mbetet e lirë, konkursi nga Këshilli shpallet sa më parë që të jetë e mundur por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë, nga dita kur kjo pozitë ka mbetur e lirë. Shpallja e vendit të lirë bëhet në faqen zyrtare të Këshillit, në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

3. Shpallja e vendeve të lira duhet të përmbajë informatat përkatëse si në vijim:

- 3.1. pozitën e lirë të shpallur;
- 3.2. gjykata apo dega ku shpallet vendi i lirë;
- 3.3. kriteret formale kualifikuese;
- 3.4. përshkrimin e detyrave të punës;
- 3.5. mënyrën e dorëzimit të aplikacionit dhe dokumentet mbështetëse; si dhe
- 3.6. afatin e fundit për dorëzimin e aplikacionit, së bashku me dokumentet përcjellëse që duhet ti bashkëngjiten, i cili afat nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) ditë.

Neni 5

Kriteret formale kualifikuese për aplikim

1. Për kandidatin për kryetar të gjykatës dhe gjyqtar mbikëqyrës mund të aplikoj vetëm gjyqtari që vjen nga radhët e gjykatës përkatëse, duke përfshirë edhe degët e saj.

2. Kandidati për kryetar të gjykatës, respektivisht gjyqtar mbikëqyrës duhet të plotësoj kriteret themelore si në vijim:

- 2.1. të jetë gjyqtar me mandat të përhershëm;
- 2.2. të mos ketë sanksion disiplinor me vendim të formës së prerë, përjashtimisht masën vërejtje jo publike me shkrim;
- 2.3. të mos ketë aktakuzë të konfirmuar për ndonjë vepër penale, përveç veprave penale të kryera nga pakujdesia;
- 2.4. të mos jetë i dënuar për vepër penale me vendim të formës së prerë, përveç veprave penale të kryera nga pakujdesia;

2.5. të ketë së paku shkallë vlerësimi të performancës “shumë mirë”.

3. Kandidati për kryetar të Gjykatës Komerciale, përveç kritereve të përcaktuara me paragrafin 2 të këtij neni, duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune si Gjyqtar i shkallës së dytë.

Neni 6

Kandidatët të cilët nuk kanë të drejtë aplikimi

1. Të drejtë për aplikim për pozitën kryetar gjykate apo gjyqtar mbikëqyrës nuk kanë:

- 1.1. anëtari i Këshillit, gjatë ushtrimit të mandatit të tij si dhe pas përfundimit të mandatit brenda periudhës kohore të përcaktuar me legjislacionin në fuqi;
- 1.2. kryetari i Gjykatës përkatëse i cili ka përfunduar mandatin e tij si kryetar i asaj gjykate, për pozitën si kryetar gjykate;
- 1.3. gjyqtari mbikëqyrës i cili ka përfunduar mandatin e tij si gjyqtar mbikëqyrës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për pozitën si gjyqtar mbikëqyrës në Dhomën e Posaçme, si dhe gjyqtari mbikëqyrës në degë të gjykatës themelore për pozitën gjyqtar mbikëqyrës në degë.

Neni 7

Shqyrtimi i Aplikacionit

1. Komisioni vlerësues, në mbështetje të Njesisë, në një afat sa më të shkurtër kohor shqyrton të gjitha aplikacionet e pranuar.

2. Në rast të refuzimit të aplikacionit kandidati, përmes Njesisë, njoftohet individualisht për arsyet e refuzimit, ndaj të cilit ka të drejtë ankese në afat prej tri (3) ditëve pune, nga dita e njoftimit.

3. Ankesa e kandidatit shqyrtohet nga Këshilli, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e përfundimit të afatit për ankesë.

Neni 8

Kriteret Vlerësuese

1. Kandidati për kryetar të gjykatës / gjyqtar mbikëqyrës përveç profesionalizmit dhe kualifikimeve për kryerjen e funksionit, duhet të ketë aftësi dhe njohuri në kryerjen e punëve të udhëheqjes dhe organizimit brenda gjykatës / degës sipas kritereve në vijim:

- 1.1. njohjen e punëve të administratës gjyqësore;
- 1.2. të qenit kreativ në punë duke lehtësuar punën e gjykatës /degës;
- 1.3. komunikimin korrekt me palë dhe kolegë brenda gjykatës / degës;
- 1.4. gatishmërinë për bashkëpunim me organizata dhe institucione tjera.

2. Vlerësimi i kritereve nga paragrafi 1 i këtij neni, të kandidatit për kryetar gjykate /gjyqtar mbikëqyrës bëhet përmes intervistës me gojë.

3. Përveç, kriterëve vlerësues të parapara me paragrafin 1 të këtij neni, Komisioni vlerësues do të vlerësojë edhe konceptin dokumentar me shkrim të dorëzuar nga kandidati me rastin e aplikimit për pozitën përkatëse dhe do të marrë në konsideratë trajnimet e specializuara, përvojën menaxheriale, vlerësimin e performancës dhe reputacionin të cilin kandidati gëzon nga ana e kolegëve gjyqtarë.

4. Koncepti dokumentar tregon vizionin e kandidatit për mënyrën e menaxhimit të gjykatës / degës si dhe ngritjes së efikasitetit në bazë të resurseve ekzistuese, i cili duhet të përmbajë:

- 4.1. vizionin në lidhje me rregullat dhe strategjitë që duhet implementuar në gjykatë / degë gjatë mandatit të tij;
- 4.2. vizionin për menaxhimin e gjykatës / degës duke përfshirë planin për reduktimin e lëndëve të mbetura dhe masa të tjera për rritjen e efikasitetit të gjykatës / degës.

5. Koncepti dokumentar sipas paragrafit 4 të këtij neni, duhet të ketë jo më pak se tre (3) dhe jo më shumë se shtatë (7) faqe.

Neni 9

Procesi konsultativ dhe mbledhja e informatave shtesë

1. Pas paraqitjes së aplikacioneve, Këshilli kërkon nga gjyqtarët e gjykatës / degës përkatëse të japin mendimin e tyre në lidhje me kandidatin / kandidatët përkatës, mendime këto që janë të karakterit konsultativ, brenda afatit prej pesë (5) ditëve. Mendimet e dhëna duhet të arsyetohen me shkrim.

2. Këshilli do të bëjë vlerësimin e përshtatshmërisë së kandidatit për kryetar gjykatë / gjyqtar mbikëqyrës nëpërmjet vërtetimit të të dhënave të dorëzuara nga kandidati, të dhënat nga regjistrat e evidencës penale dhe të dhënat që lidhen me masat disiplinore.

Neni 10

Komisioni Vlerësues

1. Këshilli pas çdo vendimi për shpallje të lirë të pozitës për kryetar, respektivisht gjyqtar mbikëqyrës, me vendim themelon Komisionin vlerësues, i cili do të bëjë intervistimin, vlerësimin dhe rekomandimin e kandidatit/ve më të suksesshëm tek Këshilli. Me të njëjtin vendim, Këshilli cakton kryetarin e Komisionit vlerësues.

2. Komisioni vlerësues përbëhet nga tre (3) anëtarë të rregullt dhe një (1) anëtar rezervë të cilët vijnë nga radhët e anëtarëve të Këshillit. Një anëtar i Këshillit mund të jetë i përfaqësuar në më shumë se në një (1) komision, por që një (1) komision në përbërje të njëjtë nuk mund të jetë përgjegjës për më shumë se një (1) gjykatë / degë në kompetencë të asaj gjykatë në rast se procesi përzgjedhës zhvillohet në të njëjtën kohë.

3. Gjatë marrjes së vendimit për përbërjen e Komisionit vlerësues, Këshilli merr parasysh parimin e barazisë gjinore dhe përfaqësimin e komuniteteve jo shumicë.

4. Anëtarët e Komisionit vlerësues nuk mund të jenë anëtarët e Këshillit që vijnë nga radhët e gjykatës/degës ku bëhet përzgjedhja.

5. Përfundimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, Komisioni vlerësues për pozitën gjyqtar mbikëqyrës përbëhet prej dy (2) anëtarëve të Këshillit dhe nga kryetari i gjykatës/ushtrues i detyrës së kryetarit të gjykatës përkatëse, dhe një (1) anëtar rezervë i cili vjen nga radhët e anëtarëve të Këshillit.

6. Zyrtarët përgjegjës të Njësisë dhe Sekretariatit, Komisionit vlerësues i ofrojnë mbështetje profesionale dhe administrative.

Neni 11 **Konflikti i interesit**

1. Konflikti i interesit paraqet çdo rrethanë e cila për subjektet bartëse të procesit të zgjedhjes dhe emërimit të kryetarit të gjykatës / gjyqtarit mbikëqyrës do të konsiderohej si interes privat që ndikon, mund të ndikojë ose duket se do të ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës, ashtu siç përcaktohet me Ligjin Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

2. Subjektet bartëse të procesit duhet të bëjnë përpjekje ta parandalojnë dhe / ose t'i shmangen çfarëdo situatë të konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Shfaqja e ndonjë konflikti interesit do të jetë po aq e dëmshme për respektin e publikut për punën e kryer nga Këshilli sikur edhe vet konflikti aktual i interesit.

3. Në rast se gjatë procesit të zgjedhjes dhe emërimit të kryetarit të gjykatës / gjyqtarit mbikëqyrës, ndonjë subjekt bartës i procesit beson se mund të ketë konflikt interesit, ai/ajo duhet ta njoftojë menjëherë me shkrim për këtë çështje kryetarin e Komisionit përkatës, i cili pas verifikimit të konfliktit të mundshëm të interesit vendos për përfundimin dhe zëvendësimin e tij/saj.

4. Në rast se konflikti i interesit gjatë procesit paraqitet nga kryetari i Komisionit vlerësues, i njëjti me shkrim e njofton Këshillin, i cili pas verifikimit të konfliktit të mundshëm të interesit vendos për përfundimin dhe zëvendësimin e tij/saj.

5. Subjektet bartëse të procesit, me rastin e paraqitjes së konfliktit të mundshëm të interesit detyrohen që menjëherë të pezullojnë çfarëdo veprimi të mëtejshëm, deri sa të vendoset lidhur me përfundimin dhe zëvendësimin e tij/saj, sipas përcaktimit të bërë me paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni.

6. Në rast se subjektet bartëse të procesit gjenden në një situatë të konfliktit të interesit me ndonjë nga subjektet që janë në proces të zgjedhjes dhe emërimit dhe një fakt të tillë e kanë mbajtur të fshehur, për subjektin bartës të procesit tërheq përgjegjësi disiplinore.

Neni 12 **Vlerësimi i kandidatëve**

1. Kandidati i cili sipas Komisionit vlerësues ka plotësuar kushtet formale për aplikim në pozitën kryetar të gjykatës / gjyqtar mbikëqyrës ftohet nga Komisioni vlerësues për intervistë sipas rendit

alfabetik. Ftesat për intervistim bëhen përmes postës elektronike, jo më vonë se pesë (5) ditë para intervistës.

2. Intervistimi me kandidatë bëhet në bazë të pyetjeve të parashtruara nga Komisioni vlerësues që lidhet me vlerësimin e kriterëve të përcaktuara me nenin 8 të kësaj rregullore. Të gjithë anëtarët e komisionit vlerësues kanë të drejtë të bëjnë pyetje apo të kërkojnë përgjigje plotësuese.

3. Kandidati mund të vlerësohet më së shumti me dyzetë (40) pikë për intervistim dhe atë:

- 3.1. njohjen e punëve të administratës gjyqësore, maksimumi dhjetë (10) pikë;
- 3.2. të qenit kreativ në punë duke lehtësuar punën e gjykatës / degës, maksimumi dhjetë (10) pikë;
- 3.3. komunikimin korrekt me palë dhe kolegë brenda gjykatës / degës, maksimumi dhjetë (10) pikë;
- 3.4. gatishmërinë për bashkëpunim me organizata dhe institucione tjera, maksimumi dhjetë (10) pikë.

4. Koncept dokumentit mund të vlerësohet më së shumti me tridhjetë e pesë (35) pikë.

5. Reputacioni të cilin kandidati e gëzon nga ana e kolegëve gjyqtarë, trajnimet e specializuara, përvoja menaxheriale, dhe vlerësimi i performancës mund të vlerësohet më së shumti njëzet e pesë (25) pikë, dhe atë:

- 5.1. reputacioni të cilin kandidati e gëzon nga ana e kolegëve gjyqtarë dhjetë (10) pikë;
- 5.2. trajnimet e specializuara në fushën e menaxhimit, maksimumi pesë (5) pikë;
- 5.3. përvoja menaxheriale, maksimumi pesë (5) pikë;
- 5.4. vlerësimi i performancës, maksimumi pesë (5) pikë.

6. Një kandidat do të rekomandohet në Këshill për emërim për pozitën kryetar i gjykatës / gjyqtar mbikëqyrës nëse i njëjti në rezultatin përfundimtar të procesit vlerësues ka arritur së paku shtatëdhjetë (70) pikë, nga njëqind (100) pikët sa janë të mundura sipas paragrafit 3, 4 dhe 5 të këtij neni.

7. Intervista me gojë regjistrohet përmes kamerave dhe për këtë njoftohet kandidati.

Neni 13

Rezultati përfundimtar i vlerësimit të kandidatit

1. Rezultati përfundimtar i vlerësimit të kandidatit sipas nenit 12 të kësaj rregullore, bëhet sipas formularit standard i cili do të jetë pjesë e kësaj rregullore. Rezultati për një kandidat arrihet duke nxjerrë mesataren e pikëve të dhëna nga secili anëtar i komisionit.

2. Rezultati i arritur për secilin kandidat shënohet në procesverbal, i cili përmban pikët e dhëna nga secili anëtar i komisionit vlerësues sipas formularit standard, i cili para së gjithash duhet të përmbaj edhe arsytim të qartë për secilën kategori dhe kriter vlerësues, si dhe pikët totale që ka marrë secili kandidat.

3. Formulari standard i vlerësimit nga secili anëtarë i Komisionit vlerësues sipas paragrafit 2 të këtij neni dhe formulari standard i procesverbalit të Komisionit vlerësues duhet të nënshkruhen nga anëtarë / anëtarët e Komisionit. Këta formularë standardë do të jenë pjesë e kësaj rregullore.

4. Pas përfundimit të vlerësimit, Njësia sipas rekomandimeve të Komisionit vlerësues njofton kandidatin për rezultatin e arritur. Njoftimit i cili para së gjithash duhet të përmbajë emrin, mbiemrin dhe rezultatin e arritur të kandidatit, i bashkëngjitet edhe një kopje e procesverbalit të Komisionit vlerësues lidhur me vlerësimin e bërë për kandidatin.

Neni 14

E drejta në Ankesë

1. Kandidati si palë e pakënaqur ka të drejtë ankesë në Këshill, për të kundërshtuar rezultatin jo më vonë se tre (3) ditë pune pas pranimit të njoftimit, nëse konsideron së është bërë gabim rreth mbledhjes së pikëve apo shkeljeve tjera procedurale sipas kësaj rregullore.

2. Këshilli, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e përfundimit të afatit për ankesë shqyrton të njëjtën dhe nëse gjen se ankesa është e bazuar merr vendim që Komisioni vlerësues brenda pesë (5) ditëve, të shqyrtojë pjesën e vlerësimit ankimor. Vendimi i Këshillit për shqyrtimin e ankesave duhet të jetë i arsyetuar.

Neni 15

Raporti final i komisionit vlerësues

1. Pas përmbylljes së procedurës ankimore, Komisioni vlerësues përpilon raportin final të kandidatëve të suksesshëm siç përcaktohet me këtë rregullore, të cilin e dërgon në Këshill për qëllim të emërimit të kandidatit.

2. Në rast se Komisioni vlerësues ka konstatuar se nuk ka kandidat të suksesshëm të cilët kanë arritur rezultatet e mjaftueshme sipas kriterëve vlerësues të përcaktuara në këtë rregullore, komisioni vlerësues në raportin final i propozon Këshillit që të ri-shpallë konkurs të ri për pozitën përkatëse.

Neni 16

Procedura e votimit

1. Pas pranimit të listës me kandidatin / kandidatët e rekomanduar nga Komisioni vlerësues, Këshilli vendos për emërim të kryetarit të gjykatës/gjyqtarit mbikëqyrës.

2. Këshilli, voton në mënyrë të fshehtë kandidatin / kandidatët e rekomanduar nga komisioni vlerësues. Kandidati i cili merr shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm konsiderohet si i emëruar për pozitën e kryetarit të gjykatës / gjyqtarit mbikëqyrës

3. Këshilli, voton në mënyrë të fshehtë kandidatin / kandidatët e rekomanduar nga Komisioni vlerësues. Kandidatët do të votohen nga Këshilli në të njëjtën kohë dhe me përdorimin e një fletëvotimi të vetëm që përmban emrat e të gjithë kandidatëve, si në vijim:

- 3.1. kandidati që merr shumicën e votave nga votat e përgjithshme, të dhëna nga anëtarët e pranishëm të Këshillit do të konsiderohet i zgjedhur;
 - 3.2. anëtari i Këshillit mund të abstenojë nga votimi para fillimit të procesit të votimit, asnjë anëtar nuk do t'i lejohet të abstenojë pas fillimit të procesit të votimit për kandidatët;
 - 3.3. nëse në raundin e parë të votimit asnjëri prej kandidatëve nuk arrin të marrë shumicën e votave, do të zhvillohet një raund i dytë me dy kandidatët të cilët kanë marrë numrin më të madh të votave në raundin e parë. Nëse dy ose më shumë kandidatë renditen të dytë për shkak të marrjes së numrit të barabartë të votave në raundin e parë të votimit, të gjithë do të marrin pjesë në raundin e dytë të votimit;
 - 3.4. nëse në raundin e dytë të votimit asnjëri nga kandidatët nuk merr shumicën e thjeshtë të votave, do të bëhet një raund i tretë i votimit me dy kandidatët të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në raundin e dytë të votimit.
4. Nëse në raundin e tretë asnjëri nga kandidatët nuk merr shumicën e thjeshtë të votave, konkursi do të ri - shpallet nga Këshilli.

Neni 17 **Procedura e emërimit**

1. Pas votimit, Këshilli:
 - 1.1. i propozon presidentit të Republikës së Kosovës emërimin e kandidatit të përzgjedhur për kryetar të Gjykatës Supreme;
 - 1.2. emëron kryetarin e Gjykatës së Apelit, kryetarin e Gjykatës Komerciale, kryetarin e gjykatës themelore, gjyqtarin mbikëqyrës në Dhomën e Posaçme në Gjykatën Supreme dhe gjyqtarin mbikëqyrës në degë të gjykatës themelore.
2. Vendimi i Këshillit për emërim të kryetarit të gjykatës / gjyqtarit mbikëqyrës duhet të jetë i arsyetuar.

Neni 18 **Dosja e Kandidatit**

1. Dosja e kandidatit përmban të dhënat si në vijim:
 - 1.1. emrin dhe mbiemrin e kandidatit;
 - 1.2. emrin e gjykatës / degës ku ka aplikuar kandidati;
 - 1.3. mendimin e gjyqtarëve të gjykatës / degës;
 - 1.4. informata mbi procedurën disiplinore;
 - 1.5. të dhënat nga regjistri i evidencës penale;
 - 1.6. mendimin dhe vlerësimin e komisionit;
 - 1.7. formulari për vlerësimin e kandidatit për kryetar të gjykatës / gjyqtarit mbikëqyrës nga anëtari i komisionit vlerësues;
 - 1.8. formulari i vlerësimit për pozitën kryetar i gjykatës / gjyqtar mbikëqyrës nga komisioni vlerësues;

- 1.9. formulari standard i procesverbalit të komisionit vlerësues; si dhe
- 1.10. materiale tjera të grumbulluara gjatë procesit të përzgjedhjes.

KAPITULLI IV PROCEDURAT PËR SHKARKIM DHE PEZULLIM

Neni 19

Shkarkimi dhe pezullimi i Kryetarit të Gjykatës dhe Gjyqtarit Mbikëqyrës

1. Këshilli mund të shkarkojë nga pozita një kryetar të gjykatës apo gjyqtar mbikëqyrës me rastin e dënimit për vepër penale, ose pas konstatimit për keq menaxhim, paaftësi apo dështim në përmbushjen e detyrave të punës që për rrjedhojë paraqet vlerësim të “dobët” të performancës të përcaktuar sipas kësaj rregullore. Shkarkimi nga pozita e kryetarit të gjykatës apo gjyqtarit mbikëqyrës nuk përbën shkarkim nga pozita e gjyqtarit.
2. Këshilli mund të pezullojë një kryetar gjykate apo gjyqtar mbikëqyrës nga kjo pozitë gjatë periudhës së hetimit për akuza të sjelljes kriminale, keq menaxhimit, paaftësisë apo dështimit në përmbushjen e detyrave të tij, pezullim ky i cili nuk përbën pezullim nga zyra gjyqësore.
3. Në rastet kur arsyeja për shkarkim dhe pezullim paraqet shkelje disiplinore, zbatohen dispozitat e Ligjit përkatës për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

KAPITULL V DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 20

Dispozitat shfuqizuese

1. Me hyrje në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen Rregulloret e Këshillit:
 - 1.1. Rregullorja Nr.09/2016 për procedurat e Zgjedhjes, Emërimit, Vlerësimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës;
 - 1.2. Rregullorja Nr.14/2016 për Ndryshim dhe Plotësimin e Rregullores 09/2016 për Procedurat e Zgjedhjes, Emërimit, Vlerësimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës;
 - 1.3. Rregullorja Nr.17/2016 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr.14/2016 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (Nr. 09/2016) për procedurat e Zgjedhjes, Emërimit, Vlerësimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës;
 - 1.4. Rregullorja Nr.05/2017 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (Nr.14/2016) për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (Nr.09/2016) për Procedurat e Zgjedhjes, Emërimit, Vlerësimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës;


- 1.5. Rregullorja Nr.01/2020 për plotësimin e Rregullores (Nr.09/2016) për Procedurat e Zgjedhjes, Emërimit, Vlerësimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës.

Neni 21
Shtojcat e rregullores

1. Shtojcat që i janë bashkangjitur kësaj rregulloreje, janë pjesë përbërëse e saj:
- 1.1. Shtojca 1: Aplikacioni për pozitën kryetar i gjykatës / gjyqtar mbikëqyrës;
 - 1.2. Shtojca 2: Formulari për vlerësimin e kandidatit për kryetar të gjykatës/gjyqtar mbikëqyrës nga anëtari i Komisionit vlerësues;
 - 1.3. Shtojca 3: Formulari i vlerësimit për pozitën kryetar i gjykatës/gjyqtar mbikëqyrës nga Komisioni vlerësues; si dhe,
 - 1.4. Shtojca 4: Formular standard i procesverbalit të Komisionit vlerësues.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

 Albert Zogaj,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Datë: 30.12.2022



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**APLIKACION PËR POZITËN E KRYETARIT
TË GJYKATËS/GJYQTAR MBIKËQYRËS
PRIJAVA ZA PRESEDNIKA
SUDA/NADZORNOG SUDIJU**

**INFORMACIONET PËR KANDIDATIN
INFORMACIJE O KANDIDATU**

Emri (emri i prindit) mbiemri /Ime (ime roditelja) prezime

Numri personal / Lični broj

Gjykata në të cilën ushtron funksionin/Sud u kome vrši funkciju:

Adresa e banimit/Adresa stanovanja:

Nr. i telefonit/Broj tel:

E-mail adresa:

Pozita / Gjykata -
dega, për të cilën ka
aplikuar
Funksija/Sud -
ogranak, za koji je
konkurisao

Këshilli Gjyqësor i Kosovës („KGJK“) si institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij siguron që gjykatat në Kosovë të jenë plotësisht të pavarura, profesionale e të paanshme dhe të pasqyrojnë plotësisht natyrën shumëetnike të Republikës së Kosovës e të ndjekin parimet e barazisë gjinore. Në drejtim të kësaj, KGJK ka për obligim kushtetues që të sigurojë përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë për pozita të gjyqtarëve në qëllim të përmbushjes së plotë të funksioneve të gjykatës e me atë edhe respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në pajtim me Konventat ndërkombëtare dhe legjisllacionin vendor.

Sudski savet Kosova („SSK“) kao potpuno nezavisna institucija u sprovođenju svojih funkcija obezbeđuje da su sudovi na Kosovu nezavisni, profesionalni i nepristrasni i da održavaju multietničnost na teritoriji Republike Kosova kao i da poštuju načela polne jednakosti. U tom smislu, SSK je obavezana Ustavom da obezbedi odabir najboljih kandidata za sudsku funkciju kako bi obezbedila potpuno i pravilno funkcionisanje sudova a time obezbedila i potpuno poštovanje ljudskih prava i osnovnih sloboda u skladu sa međunarodnim instrumentima i domaćim zakonima.

UDHËZIMET / UPUTSTVA

- 1.Kandiati duhet të plotësojë aplikacionin në mënyrë elektronike ose me shkrim në mënyrë të qartë duke përdorur lapsin me ngjyrë të kaltër. / Kandidat je dužan popuniti prijavu elektronskim putem ili pisanim, čitko i koristeći olovku plave boje.
- 2.Kandidati duhet të plotësojë aplikacionin në tërësi. / Kandidat je dužan popuniti prijavu u potpunosti.
- 3.Kandidati është i obliguar të shënojë „P/P“ (pa përgjigje) në hapësirën e pyetjes në të cilën nuk ka përgjigje. Aplikacioni i paplotësuar mund të shkaktojë eliminim të kandidatit nga përzgjedhja për pozitën e aplikuar. Të gjitha të dhënat e parashtruara nga kandidati i nënshtrohen procesit të verifikimit. / Kandidat je dužan obeležiti određeni prostor sa „B/O“ (bez odgovora) ispod pitanja na koje nema odgovor. Nepotpuna prijava može prouzrokovati eliminaciju kandidata iz daljeg postupka. Navedene informacije od strane kandidata biće podređene procesu verifikacije.
- 4.Kandidati është i obliguar t'ia bashkangjesë aplikacionit të gjitha dokumentet e kërkuara sipas Konkursit. / Kandidat je obavezan pridružiti prijavi svu dokumentaciju prema tekstu Konkursa.
- 5.Kandidati është i obliguar t'a nënshkruajë aplikacionin dhe shënojë datën e dorëzimit. Aplikacioni i cili nuk është i nënshkruar nuk do të merret parasysh. / Kandidat je dužan potpisati prijavu i navesti datum predaje. Nepotpisana prijava neće biti uzeta u obzir.
- 6.Kandidati duhet t'a dorëzojë aplikacionin personalisht, bashkë me të gjitha dokumentet e bashkangjitura apo të njëjtën ta bëjë përmes postës në adresën e cekur në Konkurs. / Kandidat je obavezan predati prijavu lično, uz svu propratnu dokumentaciju, ili da isto izvrši putem redovne pošte na adresu navedenu na Konkursu.
- 7.Aplikacioni pranohet nga KGJK me shënim të datës se aplikimit. Në qoftë se dërgesa bëhet përmes postës, e njëjta do të jetë e vlefshme nëse mban vlen me datë kur aplikacioni në pozitë të caktuar ishte i mundur sipas Konkursit. / Prijavu prihvata SSK. Na istoj se mora nalaziti datum prijave. Ukoliko je pošiljka izvršena putem redovne pošte, ista će se smatrati validnom ukoliko sadrži pečat datuma unutar datuma predviđenih Konkursom, kada se kandidat mogao prijaviti.
- 8.Aplikacioni dhe dokumentet e bashkangjitura nuk kthehen. / Prijava i propratna dokumentacija neće biti vraćeni kandidatu.

TË DHËNAT PERSONALE TË KANDIDATIT/ LIÇNI PODACI KANDIDATA

Emri (emri i prijndit) mbiemri <i>Ime (ime roditelja) prezime</i>			
Mbiemri i vajzërisë <i>Djevojačko prezime</i>		Data dhe vendi i lindjes / <i>Datum i mjesto rodenja</i>	
Gjinia/ <i>Pol</i>	mashkull / <i>muški</i>	Femër / <i>ženski</i>	Nacionaliteti / <i>nacionalnost</i>
Nënshtetësia / <i>Državljanstvo</i>		Nënshtetësia tjetër (nëse keni) <i>Drugo državljanstvo (ako imate)</i>	

ARSIMIMI I KANDIDATIT / OBRAZOVANJE KANDIDATA

Data e marrjes së diplomës apo kualifikimit tjetër akademik <i>Datum sticanja diplome ili druge akademske kvalifikacije</i>	Shënoni titullin ashtu si qëndron në diplomë duke marrë parasysh edhe emërtimin e institucionit të lartë arsimor, qytetin dhe shtetin <i>Upišite zvanje kako je napisano na diplomu, naziv visokoškolske ustanove, grad i državu</i>
Data e marrjes së diplomës apo kualifikimit tjetër akademik <i>Datum sticanja diplome ili druge akademske kvalifikacije</i>	Shënoni titullin ashtu si qëndron në diplomë duke marrë parasysh edhe emërtimin e institucionit të lartë arsimor, qytetin dhe shtetin <i>Upišite zvanje kako je napisano na diplomu, naziv visokoškolske ustanove, grad i državu</i>
Data e marrjes së diplomës apo kualifikimit tjetër akademik <i>Datum sticanja diplome ili druge akademske kvalifikacije</i>	Shënoni titullin ashtu si qëndron në diplomë duke marrë parasysh edhe emërtimin e institucionit të lartë arsimor, qytetin dhe shtetin <i>Upišite zvanje kako je napisano na diplomu, naziv visokoškolske ustanove, grad i državu</i>

TRAJNIME E SPECIALIZUARA MENAXHERIALE/ RUKOVODECE SPECIJALIZOVANA OBUKA:

Trajnime e specializuara menaxheriale:	Shënoni datat e trajnimit, emërtimin e institucionit ku është zhvilluar trajnimi dhe shteti.
Rukovodece Specijalizovane obuke:	Navedite datum obuke, naziv institucije gde je održana obuka i državu.

VLERËSIMI I PERFORMANCËS / VREDNOVANJE RADNOK UCINKA:

Perioda e vlerësimit të performancës dhe shkalla e vlerësimit: Period vrednovanja rada i stepen vrednovanja:	
---	--

PËRDORIMI I KOMPJUTERIT / SLUŽENJE RAČUNAROM

Shënoni me „x“ punët / programet të cilat dini t'i përdorni / Označite sa „x“ kompjuterske alatke / programe koje znate koristiti.

Word	Excel	Powerpoint	Të tjera / Ostalo:
Internet Explorer	Outlook	Outlook Express	Të tjera / Ostalo:
PDF Reader	ZIP	Skanim / Skeniranje	Të tjera / Ostalo:

NJOHJA E GJUHËVE TË HUAJA / ZNANJE STRANIH JEZIKA

Nivelet e njohjes së gjuhës së huaj / Nivoli znanja jezika	Të shkruarit / Pisanje						Të folurit / Govor						Të kuptuarit /Razumevanje					
	A1	A2	B1	B2	C1	C2	A1	A2	B1	B2	C1	C2	A1	A2	B1	B2	C1	C2

Shënoni gjuhët e huaja të cilat njihni dhe shënoni me „x“ njërin nga opcionet e mundësura për nivelin e njohjes së gjuhës së huaj

Navedite strane jezike koje poznajete i označite sa x neki od ponuđenih nivoa znanja.

A1 - nënkupton njohje elementare të gjuhës, kuptimin dhe përdorimin e nocioneve të thjeshta dhe të përditshme gjatë komunikimit / podrazumeva osnovno znanje jezika, razumevanje i korištenje jednostavnih i svakodnevnih izraza u komunikaciji.

A2 - nënkupton komunikim në situata të thjeshta dhe të zakonshme të cilat kërkojnë bisedë të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë mbi temadhe aktivitete të njohura mirë / podrazumeva komunikaciju u jednostavnim i uobičajenim situacijama koje zahtevaju jednostavnu i neposrednu konverzaciju o poznatim temama i aktivnostima.

B1 - nënkupton të kuptuarit e bisedës së qartë dhe standarde mbi tema të njohura mbi të cilat diskutohet në bazë ditore në punë, shkollë apo kohë të lirë. Po ashtu, ky nivel nënkupton sukses në komunikim në shumicën e situatave në të cilat haset gjatë të udhëtuarit në shtet ku follet gjuha e caktuar. Mundëson të shkruarit e një teksti të thjeshtë mbi një temë të njohur apo mbi temë të interesit personal. Ky nivel mundëson sqarimin e situatave të përjetuara me mundësi të përshkrimit të arsyeve mbi plane të caktuara. / razumevanje jasnog, standardnog razgovora o poznatim temama s kojima se svakodnevno susreće na poslu, u školi, u slobodno vreme. Uspešno suočavanje s većinom situacija koje susreće na putovanjima u zemlje u kojima se govori dotični jezik. Može napisati jednostavan tekst o poznatoj temi ili temi od osobnog interesa. Može opisati doživljaje i događaje uz kratak opis razloga za određeno mišljenje i planove.

B2 - nënkupton të kuptuarit e ideve nga tekste më komplekse mbi një temë konkrete apo apstrakte, duke përfshirë debate teknike në fushën e tij/saj të punës. Mundëson bisedë me bashkëbiseduesin i cili gjuhën e huaj në fjale e ka gjuhë amtare në nivel të caktuar të rrjedhshmërisë dhe spontanitetit. Mund të shkruajë tekst të qartë, të detajuar mbi spektër të gjerë të temave duke dhënë dhe spjeguar qëndrimin e tij/saj mbi atë teme duke përshtuar përparësitë dhe mangësinë e zgjidhjeve të mundshme alternative. / može razumeti glavne ideje složenog teksta na konkretnu ili apstraktnu temu, uključujući tehničke rasprave u svom području delovanja. Može s određenim stepenom tačnosti i spontanosti razgovarati s izvornim govornikom. Može napisati jasan, detaljan tekst na širok spektar tema i objasniti svoje stajalište na određenu temu navodeći prednosti i mane raznih rešenja.

C1 - nënkupton kuptimin e teksteve më të gjata dhe më komplekse mbi tema të ndryshme duke njohur edhe kuptime të fshehura brenda tekstit. Mund të shprehë rrjedhshëm dhe në mënyrë spontane pa kërkuar të mënyrë të dukshme shprehje që i mungojnë. Mund të përdor gjuhën në mënyrë efikase në qëllime shoqërore, akademike apo profesionale. Mund të artikulojë fjali të qarta dhe të formuluar mire e të detajuar mbi tema komplekse. /može razumeti zahtevnije, duže tekstove različitih tema i prepoznati skriveno značenje. Može se izraziti tačno i spontano bez vidljivog traženja potrebnog izraza. Može se efikasno koristiti jezikom u društvene, akademске ili profesionalne svrhe. Može artikulirati jasne, dobro sročene, detaljne rečenice o složenim temama.

C2 - nënkupton mundësinë e të kuptuarit të të gjithë asaj që dëgjohej apo lexohet. Mund të gjejë informacion nga burime të ndryshme të shkruara dhe të folura, duke rikonstruktuar argumente dhe pjesë të rëndësishme të një prezantimi të mirëfilltë. Mund të shprehë në mënyrë spontane, në mënyrë shumë të rrjedhshme dhe precize, duke dalluar nuanca në të kuptuarit edhe në situata më komplekse. /može razumeti gotovo sve što čuje ili pročita. Može sažeti informaciju iz različitih pisanih i govorenih izvora, rekonstruirajući argumente i važne delove skladne prezentacije. Može se spontano izražavati, vrlo tačno i precizno, razumevajući finije nijanse značenja čak i u složenijim situacijama.

PËRVOJA E PUNËS / RADNO ISKUSTVO

Kandidati duhet të fillojë nga vendi i tanishëm i punës, duke shënuar të gjitha vendet tjera të punës, duke specifikuar pozitën menaxheriale (nëse ka mbajtur). Në qoftë se kandidati i duhet hapësirë shtesë, i njëjti mund të shfrytëzojë hapësirën shtesë në fletën që gjendet në fund të aplikacionit, apo mund të shtojë rreshtë të rinj.

Kandidat treba započeti sa svojim sadašnjim radnim mestom, navodeći sva ostala rukovodeće pozicije (ako ih ima). Ukolika je kandidat potreban dodatni prostor, isti može koristiti dodatni list priložen na kraju prijavnog obrasca ili može ubaciti dodatne redove.

Emri i punëdhënësit / <i>Ime poslodavca</i>	
Titulli / Naziv radnog mesta	
Data dita/muaji/viti (nga - deri) <i>Datum dan/mesec/godina (od-do)</i>	
Përshkrimi i vendit të punës / <i>Opis radnih zadataka</i>	
Arsyet për shkëputjen e kontratës së punës / <i>Razlozi za prestanak radnog odnosa</i>	
Emri i punëdhënësit / <i>Ime poslodavca</i>	
Titulli / Naziv radnog mesta	
Data dita/muaji/viti (nga - deri) <i>Datum dan/mesec/godina (od-do)</i>	

Përshkrimi i vendit të punës / <i>Opis radnih zadataka</i>	
Arsyet për shkëputjen e kontratës së punës / <i>Razlozi za prestanak radnog odnosa</i>	
Emri i punëdhënësit / <i>Ime poslodavca</i>	
Titulli / <i>Naziv radnog mesta</i>	
Data dita/muaji/viti (nga - deri) <i>Datum dan/mesec/godina (od-do)</i>	
Përshkrimi i vendit të punës / <i>Opis radnih zadataka</i>	
Arsyet për shkëputjen e kontratës së punës / <i>Razlozi za prestanak radnog odnosa</i>	
Emri i punëdhënësit / <i>Ime poslodavca</i>	
Titulli / <i>Naziv radnog mesta</i>	
Data dita/muaji/viti (nga - deri) <i>Datum dan/mesec/godina (od-do)</i>	
Përshkrimi i vendit të punës / <i>Opis radnih zadataka</i>	
Arsyet për shkëputjen e kontratës së punës / <i>Razlozi za prestanak radnog odnosa</i>	
Emri i punëdhënësit / <i>Ime poslodavca</i>	
Titulli / <i>Naziv radnog mesta</i>	
Data dita/muaji/viti (nga - deri) <i>Datum dan/mesec/godina (od-do)</i>	
Përshkrimi i vendit të punës / <i>Opis radnih zadataka</i>	
Arsyet për shkëputjen e kontratës së punës / <i>Razlozi za prestanak radnog odnosa</i>	
PËRVOJA E PËRGJITHSHME E PUNËS UKUPNO RADNO ISKUSTVO	Vite/Godina Muaj/Meseci Ditë/Dana
Kandidati duhet të theksojë numrin e përgjithshëm të viteve të eksperiencës profesionale. / <i>Kandidat treba navesti ukupno relevantno radno iskustvo.</i>	
PËRVOJA MENAXHERIALE E PUNËS RUKOVODEĆE RADNO ISKUSTVO	Vite/Godina Muaj/Meseci Ditë/Dana
Kandidati duhet të theksojë numrin e përgjithshëm të viteve të eksperiencës menaxheriale. / <i>Kandidat treba navesti ukupno rukovodeco radno iskustvo.</i>	

Procedura Disiplinore / Disciplinski postupak:

Përshkruaj / Opišite:

Precedenti penal / Krivični presedan:

Përshkruaj / Opišite:

Gjuha për intervistë/Jezik intervjuar:

Pranoj të intervistohem në / Pristajem da budem intervjuisan na:

Gjuhën Shqipe/Albanski Jezik: Gjuhën Serbe/Srpski Jezik: **PUNIMET E PUBLIKUARA / OBJAVLJENI RADOVI**

Në qoftë se kandidati ka publikuar punime, emërtimin e të njëjtave si dhe vendin ku punimi është publikuar duhet të theksojë këtu. Në qoftë se punimi është publikuar në vendin me internet link, i njëjti duhet të theksohet këtu. / Ukoliko je kandidat objavio rad/radove, iste treba navesti ovde uz naziv mesta gde je rad objavljen. Ukoliko su radovi objavljeni na mestima sa internet linkom, isti treba biti naveden ovde.

ANËTARËSIMI NË ORGANIZATA PROFESIONALE / ČLANSTVO U STRUČNIM ORGANIZACIJAMA

Kandidati duhet të shënojë emërtimin e organizatës profesionale ku është anëtar/e për momentin, apo ku ka qenë i/e anëtarësuar më herët, duke theksuar edhe periudhën e anëtarësimit. / Kandidat je obavezan navesti stručne organizacije u kojima je bio/la ili je trenutno član/ica, uključujući i period članstva.

AKTIVITETI NË PERSON JURIDIK PRIVAT APO PUBLIK / AKTIVNOST U JAVNIM I PRIVATNIM PREDUZEĆIMA

Në qoftë se kandidati është anëtar i bordit në një person juridik privat apo publik këtu duhet të japë informacione si në vijim: emërtimin e personit juridik apo organizatës, datën e anëtarësimit dhe datën e ndërprerjes së anëtarësisë. / Ukoliko je kandidat član borda odbora nekog javnog ili privatnog preduzeća ili drugog pravnog lica isti treba navesti sledeće podatke : naziv pravnog lica ili organizacije, datum uclanjenja i datum prestanka članstva

DEKLARATA / IZJAVA


- Me këtë deklaroj që kundër meje nuk është ngritur aktakuza e as nuk është nxjerrë aktgjykimi jo i plotfuqishëm dënues për një vepër penale të caktuar para gjykatës kompetente. / Ovim izjavljujem da protiv mene nije potvrđena optužnica, niti je izrečena nepravosnažna osuđujuća presuda za određeno krivično djelo pred nadležnim sudom;
- Me këtë deklaroj që pajtohem që të dhënat e mia personale të shfrytëzohet në procedurën konkurrese dhe për nevojat e KGJK-së e në pajtim me Ligjin Nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligjin Nr.06/L-054 për Gjykatat dhe ligje tjera relevante. / Ovim izjavljujem da sam saglasan(a) da se moji lični podaci obrađuju u konkursnim procedurama za potrebe SSK, a u skladu sa Zakonom br.06/L-055 o Sudskom savetu Kosova, Zakonom br.06/L-054 o Sudovima, kao i drugim pozitivnim propisima;
- Me këtë deklaroj që pajtohem që informacionet lidhur me procedurën e rekrutimit të i marr përmes postës elektronike, përmes mesazheve SMS apo komunikimit me e-mail. / Ovim izjavljujem da sam saglasan(a) da obavesti o konkursnoj proceduri u kojoj učestvujem primam elektronskim putem, obaveštavanjem putem SMS poruka i/ili e-mail poruka;
- Me këtë deklaroj që jam i/e njoftuar që në faqen e internetit të KGJK-së gjenden të gjitha lajmërimet relevante lidhur me procedurën e rekrutimit, si dhe që jam i informuar që nuk do të më dërgohen përmes postës së rregullt apo telefonit lajmërimet mbi çështje për të cilat jam lajmëruar në mënyrë elektronike. / Ovim izjavljujem da sam upoznat(a) da se na službenoj internet (web) stranici SSK, nalaze sva relevantna obaveštenja vezana za sprovođenje konkursnih procedura, te da sam informisan/a da mi se neće dostavljati pismena i telefonska obaveštenja o stvarima o kojima sam obavešten/a elektronskim putem.

Nën përgjegjësinë materiale dhe penale konfirmoj që informacionet që gjenden në këtë aplikacion si dhe ato që gjenden në dokumente tjera të bashkangjitura si pjesë përbërëse e aplikacionit janë të sakta. Kuptoj që jam nën obligim të përhershëm të përmirësoj çdo informacion të pasaktë dhe të dërgoj çdo informacion relevant të cilin e mësoj pas dërgimit të këtij aplikacioni. Po ashtu kuptoj që mund të eliminohem nga mundësia për emërim në pozitë në të cilën aplikoj, respektivisht që mund të shkarkohem nga detyra e gjyqtarit në qoftë se konstatohet që kam dhënë informacione të pasakta apo kam shpjer në konkludime të pasakta.

Pod materijalnom i krivičnom odgovornošću potvrđujem da su informacije navedene u ovom obrascu, kao i u svim dokumentima podnesenim kao njegov sastavni deo, istinite i tačne. Shvatam da sam pod trajnom obavezom da ispravim svaku netačnu informaciju i da dostavim svaku drugu relevantnu informaciju koju saznam nakon podnošenja ovog obrasca. Isto tako razumem da mogu biti isključen(a) iz razmatranja za imenovanje na položaj za koji sam se prijavio(la), odnosno da mogu biti razrešen(a) sa sudske funkcije ukoliko se ustanovi da neki od podataka koje sam dostavio(la) nije tačan ili navodi na pogrešno zaključivanje.

Nënshkrimi /Potpis			
Vendi / Mesto		Data / Datum	

FAQJA SHITESË: Nëse kandidati ka informata shitesë/shpjegim për komisionin
DODATNI LIST: Ukoliko kandidat ima dodatne informacije/objašnjenje za komisiju



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDESKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KOMISIONI VLERËSUES / KOMISIJA ZA OCENJIVANJE

FORMULARI I VLERËSIMIT NGA ANËTARI I KOMISIONIT VLERËSUES PËR POZITËN E
KRYETARIT TË GJYKATËS / GJYQTARIT MBIKËQYRËS
OBRAZAC ZA OCENJIVANJE OD STRANE ČLANA OCENJIVAČKE KOMISIJE ZA MESTO PREDSEDNIKA
SUDA / NADZORNOG SUDIJU

Emri dhe mbiemri i kandidatit: Ime i prezime kandidata:	
Pozita për të cilën ka aplikuar: Pozicija za koju je konkurisao:	
Data e intervistës / Datum intervjuja	

Vlerësimi i intervistës: Ocena intervjuja:	Pikët maksimale: Mak. bodova	Vlerësimi nga anëtari i komisionit / Procena od strane člana komisije
Njohja e punëve të administratës gjyqësore; Poznavanje sudske uprave:	0- 10	
Të qenit kreativ në punë duke lehtësuar punën e gjykatës / degës; Biti kreativ na poslu, olakšavajući rad suda / ogranka:	0- 10	
Komunikimin korrekt me palë dhe kolegë brenda gjykatës / degës; Korektna komunikacija sa strankama i kolegama unutar suda / ogranka:	0- 10	
Gatishmërinë për bashkëpunim me organizata dhe institucione tjera; Spremnost za saradnju sa drugim organizacijama i institucijama:	0- 10	
Total pikët e fituara në intervistë: Ukupan broj poena postignut na intervju:	40	

Vërejtje: Duhet dhënë arsytim të qartë për secilën kategori dhe kriter vlerësues:

Napomena: Za svaku kategoriju i kriterijum za ocenjivanje mora se dati jasno obrazloženje:

1.
2.
3.
4.

Vlerësimi i koncept dokumentit: Ocenjivanje koncept dokumenta:	0- 35	
<i>Vërejtje:</i> Duhet dhënë arsyetim të qartë për vlerësimin e koncept dokumentit: <i>Napomena:</i> Pruzati jasno obrazlozenje za ocenjivanje koncept dokumenta:		
Reputacionin të cilin kandidati gëzon nga ana e kolegëve gjyqtarë: Reputacija koji kandidat uživa među kolegama sudijama:	0-10	
Trajnimet e specializuara menaxheriale: Rukovodece specijalizovane obuke:	0- 5	
Përvoja menaxheriale: Rukovodece iskustvo:	0- 5	
Vlerësimi i performancës: Ocena radnog učinka:	0- 5	
Total pikët e fituara në reputacionit, trajnimet e specializuara menaxheriale, përvojën menaxheriale dhe vlerësimin e performancës / Ukupan broj bodova postignutih za reputaciju, rukovodecu specijalizovanoj obuci, rukovodecu iskustvu i oceni radnog učinka	25	
<i>Vërejtje:</i> Duhet dhënë arsyetim të qartë për secilën kategori dhe kriter vlerësues: <i>Napomena:</i> Za svaku kategoriju i kriterijum za ocenjivanje mora se dati jasno obrazlozenje:		
1.		
2.		
3.		
4.		
Rezultati i vlerësimit nga anëtarit i komisionit: Rezultat ocenjivanja od strane člana komisije:	100	

Emri dhe mbiemri /Nënshkrimi i anëtarit të Komisionit Vlerësues _____

Ime, prezime/Potpis člana ocenjivačke komisije: _____



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KOMISIONI VLERËSUES
KOMISIJA ZA OCENJIVANJE

FORMULARI I VLERËSIMIT NGA KOMISIONI VLERËSUES PËR POZITËN E KRYETARIT TË
GJYKATËS /GJYQTARIT MBIKËQYRËS
OBRAZAC ZA OCENJIVANJE KOMISIJE ZA MESTO PREDSEDNIKA SUDA / NADZORNOG SUDIJE

Emri dhe mbiemri i kandidatit:	
Ime i prezime kandidata:	
Pozita për të cilën ka aplikuar: Pozicija za koju je aplicirao:	
Data e intervistës / Datum intervjuja	

Vlerësimi i kandidatit nga komisioni vlerësues:				
Ocenjivane kandidata od strane ocenjivačke komisije:				
	Kryetari i komisionit / Predsednik komisije:	Anëtar i komisionit / Član komisije:	Anëtar i komisionit / Član komisije:	Rezultati i vlerësimit nga anëtarët e komisionit / Rezultat ocenjivanja od strane članova komisije:
Intervistë: Intervju:				
Koncept dokumenti: Koncept dokument:				
Reputacioni, trajnimet e specializuara menaxheriale, përvoja menaxheriale dhe vlerësimi i performances /Reputacija, rukovodece specializovane obuke, rukovodece iskustvo i ocena učinka				
Vlerësimi përfundimtar i kandidatit / Konačna ocena kandidata:				
Pragu i kalueshmërisë: Prolaznost:				70 pikë / bodova

Komisioni Vlerësues / Ocenjivačka komisija:	Emri dhe mbiemri Im e i prezime:	Nënshkrimi / Potpis:
Kryetari i komisionit / Predsednik komisije:		
Anëtar i komisionit / Član komisije:		
Anëtar i komisionit / Član komisije:		

Dispozita e nenit 12, të Rregullores përcakton rezultatin i cili arrihet duke nxjerrë mesataren e pikëve të dhëna nga secili anëtar. Odredbom člana 12. Pravilnika utvrđuje se konačan rezultat ocenjivanja kandidata od strane svakog člana komisije.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Procesverbali i intervistës së kandidatit për pozitën Kryetar / Gjyqtarë mbikëqyrës
Zapisnik o obavljenom intervju sa kandidatom za mesto predsednika/nadzornih sudija

Emri dhe mbiemri i kandidatit: Ime i prezime kandidata:	
Pozita për cilën ka aplikuar: Funkcija za koju je konkurisao:	
Vendi / Mesto	
Data e intervistës Datum intervjuja	
Koha e fillimit: Vreme početka:	

Informohet për videoinqizimin: Obaveštava se o video snimanju:	Po/Da <input type="checkbox"/>	Jo/Ne <input type="checkbox"/>
Prezantimi i kryetarit të komisionit vlerësues për përbërjen e komisionit / Prezentacija predsednika ocenjivačke komisije o sastavu komisije	1. _____ 2. _____ 3. _____	
Të pranishëm të tjerë: Ostali prisutni:		
Deklarimi i kandidatit para fillimit të intervistës lidhur me komisionin vlerësues apo ndonjë çështje tjetër: Izjava kandidata pre početka intervjuja u vezi sa ocenjivačkom komisijom ili bilo kojim drugim pitanjem:		
Koha e përfundimit të intervistës / Vreme završetka intervjuja		

I

Dispozita e nenit 13, par. 1 dhe 2 te Rregullores përcakton rezultatit përfundimtar të vlerësimit të kandidatit i cili shënohet në procesverbal.
Odredbom člana 13. st. 1 i 2 pravilnika utvrđuje se konačan rezultat ocenjivanja kandidata koji se evidentira u zapisniku.

Vlerësimi i kandidatit nga komisioni vlerësues / Ocenjivanje kandidata od strane ocenjivačke komisije:				
	Kryetari i komisionit / Predsednik komisije	Anëtari i komisionit / Clan komisije	Anëtari i komisionit / Clan komisije	Rezultati i vlerësimit nga anëtarët e komisionit / rezultat procene clanova komisije:
Intervista / Intervju:				
Koncept dokumentit / Koncept document:				
Reputacioni, trajnimet e specializuara menaxheriale, përvoja menaxheriale dhe vlerësimi i performances / Reputacija, rukovodece specijalizovana obuka, rukovodece iskustvo i ocena radnog učinka				
Vlerësimi përfundimtar i kandidatit: Konačna ocena kandidata:				
Pragu i kalueshmërisë / Prolaznost:				70 pikë / bodova

Përshtypjet e përgjithshme të komisionit vlerësues lidhur me kandidatin: Opšti utisci ocenjivačke komisije o kandidatu:

Komisioni Vlerësues: Ocenjivačka komisija:	Emri dhe mbiemri: Ime i prezime:	Nënshkrimi: Potpis:
Kryetari i komisionit: Predsednik komisije:		
Anëtari i komisionit: Član komisije:		
Anëtari i komisionit Član komisije:		

Procesmbajtësi: Zapisničar:	Emri dhe mbiemri / Ime i prezime:	Nënshkrimi / Potpis: